

# Merr vaksinën kundër gripit në Skåne

Çdo vjeshtë dhe dimër vjen gripi në Suedi. Gripi ngjitet shpejt në mes të njerëzve. Disa njerëz mund të sëmuren rëndë. Prandaj është mirë që të merret vaksina për çdo vit.

Gripi shkaktohet nga virusi. Gripi shkakton psh. temperaturë, kokëdhimbje dhe dhimbje fyti.

Ti e përballon gripin më mirë nëse vaksionohesh. Një shumicë nuk sëmuren fare. Ndërsa kë e prek gripi zakonisht nuk sëmuret aq shumë.

Vaksina kundër gripi ekziston që moti dhe përdoret në tërë botën. Prandaj kjo vaksinë është e sigurt.

## Vaksionohu nëse je në rrezik të sëmuresh rëndë

Shumica e përballojnë gripin mirë dhe nuk kanë nevojë të vaksionohen. Por disa persona sëmuren rëndë. Për shembull nëse veq kanë ndonjë sëmundje tjetër. Ata duhet të vaksionohen çdi vit.

Vaksionohu nëse ndonjërat nga të poshtëshënuarat përputhen me ty:

- Ti je 65 vjeçar apo më i moshuar.
- Ti je shtatëzënë pas javës së 16-të.
- Ti ke një sëmundje zemre. Për shembull pamjaftueshmëri të zemrës.
- Ti ke një sëmundje mushkërie. Për shembull sëmundjen KOL apo astmë të rëndë.
- Ti e ke diabetin tipi 1 apo tipi 2.
- Ti ke një sëmundje apo merr terapi e cila e dobëson shumë sistemin e imunitetit.
- Ti ke pamjaftueshmëri kronike të veshkëve dhe ato funksionojnë më dobët.
- Ti ke pamjaftueshmëri kronike të mëlçisë dhe ajo funksionon më dobët.
- Ti ke mbipeshë të madhe.
- Ti ke një sëmundje neuromuskulare që ndikon në frymëmarrjen tënde. Një sëmundje neuromuskulare bënë që muskujt e trupit dobësohen dhe funksionojnë më dobët.
- Ti ke disa aftësi të kufizuara.

## **Pyete mjekun tuaj nëse je i pasigurt**

A ke ndonjë sëmundje dhe nuk din se rrezikon të sëmuresh rëndë nga gripi? Atëherë duhet pyetur mjekun tuaj.

## **Vaksionohu për të mbrojtur dikë tjetër**

Në disa raste duhet të vaksionohesh për të mbrojtur dikë tjetër.

Për shembull në këto raste:

- Ti banon me dikë i cili e ka shumë të dobët sistemin e imunitetit.
- Ti përkujdesesh për dikë i cili ka shumë të dobët sistemin e imunitetit.

## **Vaksionohu në shtëpinë e shëndetit**

Telefenoj shtëpisë së shëndetit nëse dëshiron të vaksionohesh

Ti mund të vaksionohesh nga këto data:

- 3 nëntor nëse rrezikon të sëmuresh rëndë nga gripi. Atëherë vaksina është falas.

Mund të marr deri në dy javë derisa vaksina të jap efektin e plotë.

## **Vaksionohu çdo vit**

Vaksionohu çdo vit për të qenë i mbrojtur nga gripi. Sepse vaksina të mbron vetëm për një vit. Virusi që shkakton gripin ndryshon dhe në vitin tjetër mund të jetë më ndryshe. Kjo është arsyeja që duhet të vaksionohesh për çdo vit. Përndryshe nuk je i mbrojtur nga gripi.